



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo




Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.05.2021**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. **Smajl Latifi**, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të LMT-së, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm!



Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit për këmbimin e pronës publike komunale me pronë private P – 71510068 – 02440 – 0 Ratkoc;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i plotësim ndryshimit të vendimit 01 Nr. 180/21, i datës: 29.03.2021 të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i plotësim ndryshimit të vendimit 01 Nr. 181/21, i datës 29.03.2021 të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Plotësim ndryshimit të rregullore për vendosjen e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Rahovecit 01 Nr. 2558, të datës 27.06.2014;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 189/21, të datës 29.04.2021;

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 190/21, të datës 29.04.2021;
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 191/21, të datës 29.04.2021;
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr. 192/21, të datës 29.04.2021;
12. Informatë nga DSHPS-ja rreth pandemisë Covid-19;
13. Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën janar – prill.

Kryesuesi – Të nderuar kolegë kuvendarë, a pajtoheni me rendin e ditës, atëherë e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet renditi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka sa i përket procesverbalit, atëherë meqë nuk kemi, e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës;

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për ju, nënkryetarin, anëtarët e kuvendit, drejtorët, përfaqësuesit e mediave, të OSBE-së, KFOR-it, LMT-së dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë desha me ngritë një çështje që është në interesin e qytetareve të komunës së Rahovecit. Pra, fjala është për rrugën Pataqan i Epërm që del në rrugën për Rahovec dhe Drenoc, mundësisht që nëse ka kushte me intervenua aty sa më shpejtë pasi është një kthesë shumë e keqe edhe është një rrezik permanent në atë rrugë, kur kyçesh prej asaj rruge që del në rrugën Rahovec-Drenoc, vërtetë është shumë e rrezikshme dhe kanë ndodhur shumë aksidente. Pra, duhet të intervenohet aty që me një lakore me krijua apo një pasqyrë me përmasa të mëdha me vendos aty që me pas mundësi me u pa rruga andej, sigurisht se do të evitonim shumë probleme apo shumë momente të këqija aty. Kështu që kisha kërkuar prej qeverisjes komunale që mundësisht me shqyrtuar këtë çështje dhe me realizua këtë që me pas mundësi me i ikë rrezikut të gjithë kalimtarët e rastit që janë atypari.

Ali Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë asamblastë dhe gjithë të pranishmë. Edhe në seancën e kaluar e kam ngritur një çështje por fatkeqësisht nga drejtori i shërbimeve publike nuk kam marr përgjigje as me shkrim dhe as në seancë. Ka qenë çështja për projektin e trotuareve në komunën e Rahovecit se deri ku ka shkuar ky proces mirëpo nuk kam marr përgjigje rreth kësaj, kështu që shpresoj që në këtë seancë të marr përgjigje. Po ashtu desha me bo një koment sa i përket projektit të kanalit të ujërave atmosferik në qytet dhe asfaltimin e atij segmenti, pasi vërtetë është bërë një punë e mirë në atë segment dhe shpresoj se do të funksionoj shumë mirë dhe të mos kemi telashe me vërshime siç kemi pasur vitet e kaluara.

Fehmi Cena – Përshëndetje për ju, nënkryetarin, drejtorët e drejtorive, kolegë këshilltarë, media dhe gjithë të pranishmit në këtë sallë. Unë desha me i ngritë dy çështje që më shumë kanë të bëjnë edhe me kryetarin por është edhe nënkryetari prezent dhe besoj që mundet me na dhanë përgjigje, E para ka të bëjë rreth rrugës

Dëshmorët e Pashtrikut, që është një çështje që e kam ngritur edhe me përpara për ri-rregullimin e rrugës pasi ka që dy vjet që është vendosur elektrifikimi nëntokësor dhe ka të meta kjo rrugë dhe janë bërë disa thellime apo gropa që kanë qenë dhe vazhdojnë me qenë ende pengesë për udhëtarë dhe automjete. E kemi marr zotimin këtu se do të rregullohet kjo rrugë pastaj janë edhe trotuaet që nuk është bërë asgjë në këtë drejtim pasi është një rrugë e një lagje të madhe të qytetit. Dhe gjithashtu kam kërkuar që së paku në dy vende me bo ndërhyrje për kanalizime për ujërat atmosferike sepse sa herë bie shi janë dy vende që krijohet uji aty dhe bëhet pengesë për kalimin e udhëtarëve, kështu që aty duhet të intervenohet me disa gypa dhe puseta. Drejtori i shërbimeve publike është në njohuri për këtë dhe janë zotuar edhe kryetari edhe drejtori por nuk është bërë për vitin e kaluar asgjë dhe pyetja ime është që: a është në plan edhe për këtë vit me u rregullua kjo pasi nuk është vetëm kërkesë e imja por është kërkesë edhe e qytetarëve të lagjes pasi ata kanë kërkuar edhe kur kemi mbajtur dëgjime buxhetore publike, pra, të njëjtën gjë e kanë kërkuar. Çështja e dytë është kërkesa e qytetarëve të lagjes së njëjtë për hapjen e rrugës se re që lidh rrugën Dëshmorët e Pashtrikut me rrugën Gëzim Hamza që ka dalje te Palestra Sportive. Pra, është një rrugë e re që është kërkuar dhe që mendoj se është shumë e rëndësishme dhe jetike për lagjen tonë, edhe këtu e di që është punuar diçka dhe kryetari na ka dhënë vitin e kaluar disa shpjegime dhe ka premtuar se do të punohet në këtë aspekt. Kështu që po me intereson që është edhe kërkesë e qytetarëve se a po punohet dhe a është bërë ndonjë hap përpara në këtë aspekt dhe deri ku kanë shkuar punët.

Munib Durguti – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Pyetja ime ka të bëjë me drejtorinë e shërbimeve publike konkretisht për semaforin tek ambulanca e qytetit, pasi ka ankesa të shumta rreth vendosjes së këtij semafori pasi që ky semafor është vetëm duke e bllokuar komunikacionin dhe asnjë të mirë prej tij momentalisht nuk ka, për arsye se aty kemi 5 rrugë kurse me këtë semafor trajtohen vetëm 4 rrugë që ndërliken aty, kështu që kemi ankesa të mëdha prej lagjes që nuk trajtohet me semafor dhe ata në momentin kur shkojnë për shtëpitë e tyre nuk e din a me respektua semaforin apo me shkelë rregullin që është e paraparë me semaforë. Pra, kjo është shqetësimi i parë ndërsa i dytë, ky semafor në shumicën e rasteve e bllokon hyrjen e emergjencës, pra, ju lutem që këtë problem sa më parë me zgjedh, pasi atë semafor duhet ta ktheni vetëm me dritën e verdhë e cila sinjalizon lëvizjen me kujdes të shtuar dhe asgjë tjetër. Pra, për derisa i kemi 5 rrugë atëherë të 5 rrugët duhet të trajtohen me semaforë apo duhet të mbyllem atë semaforë dhe gjithashtu arsyeja tjetër është shumë me rendësi, hyrja në emergjencë pasi ka pasur shumë raste që nuk kanë mundur autoambulanca në emergjencë për shkak të kolonës që është krijuar aty nga ky semafor. Pra, duhet ta merrni në konsideratë këtë problematike dhe t'i jepni një zgjidhje të qëndrueshme.

Kajtas Berisha – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetar, drejtor të drejtorive, kolegë, kuvendarë, përfaqësues të mediave dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Desha të bëj dy pyetje për drejtorin e shërbimeve publike lidhur me furnizimin gjegjësisht ndërhyrjen e tensionit të lartë që furnizohen fshatrat Drenoc, Senoc, Pastasel e Zatriq. Furnizimi aktual është nëpërmjet Pataqanit të Ulët, të Epërm dhe Nashpall dhe sa herë që kemi mot të papërshtatshëm ka probleme me furnizim me rrymë edhe me këtë tension prej fillimit të furnizimit me rrymë prej vitit 1968 nuk ka pasur asnjë lloj ndërhyrje dhe gjithashtu telat e rrymës janë shumë të hollë për furnizim. Kështu që do të ishte mirë që me pas mundësi që furnizimi me rrymë me ardh në drejtim të Drenocit dhe Senocit që me largua nga ajo pjesë fushore, që me qenë furnizimi më i mirë. Pyetja e dytë ka të bëjë me kërkesën e kahershme e banorëve tek një lagje e Pastaselit afërsisht 50 shtëpi dhe një pjesë e fshatit Senoc të kyçen në një trafo, në mënyrë që të zëvendësohet trafo apo të vendoset një transformator më i madh apo të vendoset një trafo e re. Për këtë lagje të Pastaselit lokacioni është i sigurt nga ana e banorëve pasi në gjendjen aktuale sidomos dimrit nuk mund të kryejnë as shërbimet elementare të amvisërisë, pa përforcues të rrymës që i ka gati secila shtëpi. Ju faleminderit dhe shpresoj që do ketë zgjidhje për këta banorë.

Masar Popaj – Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtor, kolegë delegat edhe ju te pranishëm. Edhe para kësaj seance kam bërë të njëjtën pyetje, pra, pyetja ime ka të bëjë me kompaninë Ekoregjioni por nuk kam marr përgjigje, ndaj të cilës ka ankesa të shumta në lidhje me situatën e krijuar pas ndryshimeve të bëra nga ju. Fshati Xerxë e Fortesë por sigurisht edhe qyteti kanë hasur ne telashe në lidhje me parapagimet e bëra ndaj operatorit Ekondrinia, e të cilat pagesa po i kërkon operatori i tanishëm Ekoregjioni. A mund te na tregoni se si e parashihni të zgjidhni këtë situatë?

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë kam një kërkesë për rrugën kryesore ne fshatin Brestoc, e di që është kompetencë e ministrisë por kërkoj nga ju si komunë që të përcjellni këtë në ministri që në rrugën kryesore është shemb dhe është shumë ne gjendje të keqe pasi gati është me u shemb edhe asfalti, kështu që duhet urgjentisht të bëhet një mur mbrojtës që të evitohet rreziku në atë vend.

Shqipe Kryeziu – Unë kam një kërkesë për Kryetarin e Komunës sa i përket çështjes së shujtave, pasi siç e dimë një mësimdhënës e ka fituar padinë ne gjykatë ndaj DKA-së për çështjen e shujtave, kështu që kisha kërkuar sqarim rreth kësaj çështje.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje kryesues dhe ju gjithë kuvendarë. Çështjen e parë që po dua me ngritë në raport me një rrugë që është shtruar tani konkretisht rruga Kasim Zhuniqi në drejtim të Celinës, që është një shpërthim i një gypi për ujitje të tokës, nuk e di a keni intervenuar mirëpo të paktën deri javën e kaluar kur unë e kam pa nuk është intervenuar në atë pjesë dhe po shpresoj që duhet me rregullua atë problem duke pasur parasysh se jemi në kohë të mbjellave dhe kjo në një shpërthim mundet me ju kushtua gjithë bujqve në atë pjesë. Pastaj çështja tjetër është në kuadër të shërbimeve të vaksinimit të qytetarëve e kemi një kategori kryesisht moshë e shtyrë që nuk i kanë fëmijët në Kosovë pasi jetojnë jashtë. Kështu që a keni ndonjë plan konkret lidhur me vaksinimin e tyre dhe si kësaj kategorie do te ju ofrohet shërbim pasi ata nuk kanë qasje ne informacion por as nuk kanë mundësi me ardh me u vaksinua.

Fatmir Iska – Përshëndetje i nderuar kryesues, kuvendarë të nderuar, drejtorë, media dhe ju gjithë të pranishëm. Unë do të mundohem të përgjigjem për pyetjet e parashtruara por sigurisht edhe për disa pyetje do të përgjigjen edhe drejtorët pasi janë edhe më kompetent. Pyetja e parë ishte nga kuvendari Rasim Fazliu rreth rrugës Pataqan i Epërm-Drenoc, që realisht kishte edhe një fatkeqësi në atë rrugë pasi të dy drejtorët tanë kanë pasur edhe aksident aty, fatmirësisht kanë shpëtuar dhe janë mirë. Vërtetë ajo rrugë ka nevojë për secilin njeri dhe jo vetëm për banorët e asaj zone, kështu që unë besoj që është një besim i vogël por që mundet me u rregullua me vendosjen e disa shenjave të komunikacionit nëse eventualisht por sigurisht edhe vendosjen e ndonjë pasqyre, por sigurisht pa e harruar edhe kufizimin e lëvizjes, pasi aty nuk besoj që është e lejuar më tepër se 50 pasi është e rregulluar me shenja të komunikacionit, pastaj edhe shoferët e pandërgjegjshëm duke tejkaluar shpejtësinë edhe ndodhin këto aksidente. Pastaj pyetja e parashtruar nga Ali Morina rreth trotuareve ne komunën e Rahovecit për drejtorin e shërbimeve publike, sigurisht se kjo pyetje ishte edhe në mbledhjen e kaluar të kuvendit dhe unë besoj që drejtori Përparim Krasniqi do të përgjigjet këtu. Ndërsa sa i takon kanalit atmosferik ne rrugën Xhelal Hajda, ajo është testuar me shiun e fundit, kështu që unë besoj që është funksional por është një pjesë e vogël afër një lokali që barnatore bujqësore ka një nivelizim ne një perimetër 4-5 metra dhe shpresoj se duhet me u rregullua edhe ajo. Pastaj asamblisti Fehmi Cena rreth rrugës Dëshmorët e Pashtrikut, pastaj trotuari, ujërat atmosferike, sigurisht se ne kemi ne projekt edhe hapjen e rrugës, po ashtu edhe rregullimin e kanalit për ujërat atmosferike në rrugën dëshmorët e Pashtrikut dhe ne momentin kur rregullohet kjo atëherë nënkuptohet edhe rruga dhe gjithashtu edhe aty ku ka hapësirë edhe rregullimin e trotuareve. Gjithashtu edhe ne hapje të kësaj rruge planifikohet që ky kanal për ujërat atmosferike të lidhet me pjesën e poshtme edhe krejt kjo pastaj derdhet në lumin Dullo. Ndërsa sa i takon hapjes së rrugës sigurisht se ne jemi ne procedurë qysh nga mandati kur ka qenë kryetar Qazim

Qeska për hapjen e kësaj rruge dhe kemi ardhur në përfundim kur ministria e Financave dhe komisionet përkatëse në Ministrinë e Financave apo ministrinë e Planifikimit hapësinor e kanë bërë vlerësimin e pronës dhe pronarët nuk janë pajtuar me vlerën që ju është ofruar dhe më pastaj kanë bërë edhe ankesë. Kështu që deri në momentin kur e merr epilogun final kjo do të shkon kështu, pasi që nuk mund të veprojmë kundër ligjit për arsye se duhet me i respektua procedurat ligjore. Prandaj, deri sa të përfundojë kjo, nuk besoj që mundet me u bo, pos përjashtimit prapë me vullnetin e atyre në biseda me ata për rregullimin e kanalit atmosferik që lidhet me rrugën kryesore poshtë. Pastaj, pyetja e parashtruar nga Munib Durguti rreth semaforit tek ambulanca, për këtë kemi diskutuar edhe seancën e kaluar dhe unë po besoj që drejtori e ka dhënë një përgjigje dhe për këtë flasin ekspertet e jo na pasi nuk jemi të fushës së komunikacionit. Kështu që ekspertet kanë folur dhe kanë konstatuar se aty nuk duhet të vendoset semafori dhe është shqetësim dhe brengë e atyre banorëve që jetojnë aty mirëpo ekspertet nga shteti i Maqedonisë që kanë qenë në vendin e ngjarjes dhe e kanë rregulluar këtë pjesë dhe semaforët duhet me qenë aty prandaj edhe ne kemi konsideruar që duhet me u vendos aty semaforët dhe gjithashtu është emergjencia dhe krejt kjo kuptohet në situata emergjente se si vepron një shofer, që gjithashtu edhe kjo është e rregulluar me ligj. Pastaj pyetja e parashtruar nga asamblisti Kajtaž Berisha rreth furnizimit me rrymë dhe tensionit të dobët, sa i takon edhe Drenocit për furnizimit që ka por edhe vendosjes së trafos në një lagje të Pastaselit por edhe një pjesë të Senocit. Kështu që për të gjitha këto është kompetente KEDS-i pasi vërtet kemi probleme edhe këtu në Rahovec në një lagje që quhet Bregu i diellit, po ashtu është kërkesë e kahershme e banorëve për vendosjen e një trafos në pjesën tek rrasat dhe që është ndarë vendi mirëpo ende kemi probleme edhe me KEDS-in pasi nuk mundemi me sigurua edhe trafon, pasi nuk është në kompetencën tonë vendosja e trafos, furnizimi me rrymë, tensioni me i mirë. Kështu që kryetari ka pasur një takim me udhëheqësin e KEDS-it dhe presim disa projekte por edhe premtime prej tyre të vendosjes së këtyre trafosve e pastaj në vazhdimësi se sa ka me qenë investimi i tyre. Pastaj pyetja e parashtruar nga Masar Popaj rreth Ekoregjionit dhe Ekodrinisë, unë mendoj se drejtori i shërbimeve publike do të ju përgjigjet, e di që është shqetësim me vend por sigurisht se duhet të kontrollohet me saktë kjo punë. Pastaj pyetja e drejtuar nga Florida Bajraktari, gjithashtu është shqetësim me vend për shqetësimin e shembjes së rrugës, ajo e përmendi se është kompetencë e ministrisë por ajo çka ne mundemi me bo pasi edhe ne kalojmë aty dhe e kemi pa se është një kthesë shumë e rrezikshme, dhe ne si komunë e kemi një kod për intervenime emergjente për rregullimin e mureve mbrojtëse do të shohim sa do të kemi mundësi aty me intervenua për arsye buxhetore, por drejtori mundet me na dhanë ndonjë përgjigje rreth kësaj nëse ka mjete buxhetore sigurisht se investimi është me vend dhe sigurisht se drejtori mundet me na tregua se çka mundemi me bo nëse ka buxhete rreth rregullimit të një muri mbrojtës në mënyrë që të mbrohet ajo pjesë ku është shembur dheu. Pastaj pyetja e parashtruar rreth shujtave, e di edhe unë se një punëtorë e arsimit e ka fituar rastin në gjykatë dhe ne jemi proces që kjo të shkojë në procedura të rregullta duke i përjashtuar procedurat e gjykatave pastaj procedurat e përmbauesve, për arsye se edhe punonjësit arsimor edhe komuna në këtë rast do të dëmtohet për arsye se avokati kërkon një përqindje të punës por edhe përmbauesi kërkon edhe prej juve por edhe për mos realizim të kësaj kërkesë të juaj atëherë dëmtohet edhe komuna. Ne kemi diskutuar edhe me drejtorin e Financave edhe me kryetarin, ndoshta nuk mund të jetë pagesa në tërësi për shujta për të gjithë arsimtarët për shumen sa ka qenë por krejt kjo varet prej mundësive buxhetore, kështu që jemi në proces dhe po besoj që ka me u rregullua edhe kjo çështje. Pastaj pyetja e parashtruar nga asamblisti Ali Zhuniqi rreth rrugës Fortesë – Celinë, për këtë nuk kam ndonjë informatë mirëpo besoj që drejtori do të përgjigjet, ndërsa sa i takon vaksinimit të personave me nevojë të veçanta, kështu që ne kemi një ekip mobil që është ekip profesional i vaksinimit dhe sa për informatë mundem me përmend që një ekip i joni është duke asistuar në sallën 1 Tetori në Prishtinë në ndihmë të ministrisë së shëndetësisë. Pra edhe në këto raste është ekipi dhe

besoj qe drejtoria e shëndetësisë i ka te regjistruar por edhe qytetaret që paraqesin kërkesë pa ndonjë hezitim ne jemi te gatshëm për me i krye këto punë. Në pyetjet që nuk kam mundur me u përgjigj, ndoshta drejtoret kanë me plotësuar mua ne përgjigjet e mia apo eventualisht kanë për te shtuar me shume diçka sa i përket pyetjeve te parashtruara.

Munib Durguti – Unë pajtohem se secili projekt hartohet prej eksperteve dhe ekspertet nuk mund t'i parashohin të gjitha pasojat në momentin e hartimit të projektit, pasi janë njerëz edhe ata, kështu që këtu janë ankesa jashtëzakonisht të mëdha dhe ato dy rrugë që i ceka nuk po trajtohen me semafor dhe ata banor që janë aty kur te shkojnë ne shtëpi secilën herë duhet me shkelë rregullën e semaforit. Kështu që me qenë një polic aty menjëherë i shqipton gjobën pasi që ligji nuk bën përjashtim. Pastaj aty po bëhet kolona para hyrjes ne ambulancë dhe gjithashtu e kuptoj shkathtësinë e shofereve te autoambulancës pasi ata e kanë përditshmëri atë punë mirëpo aty vazhdimisht po krijohen kolona. Unë e kujtoj para disa seancave doktori Fehmi Cena te njëjtin shqetësim e ka ngritë pasi po krijohen kolona dhe po vështirësohet hyrja ne emergjencë. Kështu që do te ishte mirë me gjete një zgjidhje pak me te përshtatshme dhe jo me i largua semaforët por me i kthye ata semafora me një sinjalizues i cili tërheq vëmendjen për një lëvizje me kujdes te shtuar. Do të ishte më e përshtatshme aty pasi ne nuk jemi ekspert të asaj fushe por aty do të ishte më e përshtatshme aty me u vendos rreth rrotullimi por e shohim se nuk ka hapësirë te nevojshme.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë kuvendarët e pranishëm, media, monitorues dhe gjithë ju te pranishëm ne sallë. Unë po besoj që te gjitha përgjigjet veç i ka dhënë nënkryetari mirëpo nëse ka mbet dikush që ska marr përgjigje te mjaftueshme atëherë unë do te jem këtu për sqarime shtesë. Tani do te lidhem lidhur me kryqëzimin tek rruga Ali Hasku, ne kemi bërë shume ekspertizë aty dhe kemi lanë me shume se dy javë semaforët e ndezur me ngjyrë të verdhë që të bëhet një lloj testimi për hyrjen dhe lëvizjen e veturave në të gjitha segmentet rrugore. Kështu që është një variant i ri që ka dalë nga ky problem ne rrugën Ali Hasku, që do të bëhet një rrugë e re mbi ato shtëpi për shkak se nëse do te vendoset një semafor duhet të jetë rruga dy kahëshe, pasi në rrugën njëkahëshe nuk mundet të vendoset semafor pasi është ekspertizë dhe nuk mundet te shkelet ky rregull komunikacioni. Sa i përket çështjeve tjera, e kemi bërë një opsion që ndoshta nuk ka qenë variant i mirë, që për 4 sekonda te gjithë semaforët do te qëndrojnë në zonë të kuqe në mënyrë që rruga Ali Hasku, vetura të ketë mundësi për lëvizje të hyn apo të del. Dhe në bazë të matjeve që janë bërë për dy javë sa ka qenë semafori në kryqëzim me ngjyrë të verdhë, pra janë bërë këto matjet e sigurisht me mënyrën që e kemi vendos treguesin se do te lëviz vetura atëherë kemi ardh ne përfundim që 4 sekonda te jenë te bllokuar ne katër rrugët kryesore ne mënyrë që rruga Ali Hasku te jete e lire për hyrje dalje te veturave. Ndërsa sa i përket emergjencës, fatkeqësisht ndoshta rruga është shume afër por e dimë që ne rregullat e komunikacionit, emergjenca kur është ne lëvizje te gjitha veturat që janë ne rruge duhet te I japin përparësi për lirimin e rrugës. Pra ne I kemi bërë te gjitha variantet mirëpo variant me I përshtatshëm që tash n a ka dale është se do te krijohet një rrugë e re mbi atë rruge dhe do te bllokohet ajo rrugë aty Ali Hasku që mos me pas probleme me semaforë, pra ka mundësi që do te ndodhë një shpronësim aty ne pjesën aty lart dhe do te lidhet me rrugën Avdullah Bugari dhe do te kalohet edhe semafori ne atë kryqëzim. Pra kjo besoj që do te jet zgjidhja me adekuate për atë segment rrugor. Sa i përket edhe çështjeve tjera, do te jap edhe disa shpjegime tjera e sidomos Deshmoret e Demokracisë që përmendi me herët edhe doktori, kështu që ne po ju njoftojmë se me ministrinë e infrastrukturës e kemi një kodë që ka kaluar përmes ligjit te buxhetit vitin e kaluar dhe me marrëveshjen për memorandumin që kemi pasur sivjet ne Mars para se me ardh qeveria e re, mirëpo tash ju informoj se qeveria e re i ka ndërpre te gjitha memorandumet, mirëpo ne si komunë e kemi iniciuar procedurën pasi janë diku dhjetë segmente rrugore ne Rahovec që do te trajtohen, e pikërisht është edhe kjo rruga dëshmorët e demokracisë që do te ketë edhe trajtim te ujërave fekale atmosferike, instalime nëntokësore, pastaj asfaltimi

i ri i rrugës që do te trajtohen te gjitha elementet. Ne si komunë nuk do ta ndërpremë procedurën pasi që jemi ne procedure te tenderimit dhe shpresojmë se edhe ministria do te kthejnë një përgjigje pozitive që mos te ndaloj këtë procedure për shkak se ka kaluar ne ligjin e buxhetit dhe nuk është në kodin e bashkëfinancimit me komunën. Sa i përket çështjeve tjera do te lidhem me pyetjen e parashtruar nga Masar Popaj, për çështjen e Ekoregjionit dhe ne kemi bërë një marrëveshje me kompaninë Ekodrininë dhe Ekoregjioni se parapagimi që është marrë prej operatorit nga kompania private do te kthehen mjetet nga kompania Ekodrinia dhe të kalojnë ne kompaninë Ekoregjioni dhe do te fillojmë me procedurat që ka ekoregjioni dhe kjo çështje do te zgjidhet shume shpejt. Po ashtu sa i përket edhe pyetjes e parashtruar nga Rasim Fazliu per rrugën e Drenocit, ne me intervenime emergjente kështu që kemi dhe drejtorin e Financave që është edhe menaxher i projektit për sinjalizime horizontale dhe vertikale. Për momentin me intervenime emergjente do ti heqim disa barriera që janë krijuar me dhe te krijohet hapësire që me pas mundësi që me u pae rruga prej rrugës mirëpo ne te ardhmen do te shohim mundësin që ndoshta edhe vendosjen e një rreth rrotullimi te vogël me standarte që lejohet nëse kemi hapësirë për shkak se ka edhe prona private aty, por si do qoftë ne me intervenime emergjente do të bëjmë heqjen e dheut aty dhe te shihet pamja prej rrugës ne rruge. Sa i përket trotuareve, ne kemi shpallur procedurën për ndërtimin e 13,8km ne tërë territorin e komunës se Rahovecit ne bazë te kërkesave te qytetareve që kemi marr edhe prej këshillave te fshatrave për vendosjen e trotuareve ne te gjitha lokacionet ku janë kërkesa emergjente. Tani jemi ne procedurën e tenderimit dhe me 7 qershor hapet procedura dhe do te shohim pastaj vazhdojmë me procedura te reja te vendosjes se lidhjes se kontratës.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për të gjitha sqarimet, atëherë të nderuar kolegë kuvendarë kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit për këmbimin e pronës publike komunale me prone private P – 71510068 – 02440-0 Ratkoc

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtor te drejtorive, anëtarë te kuvendit dhe gjithë ju te pranishëm. Para juve keni vendimin e kryetarit te komunës për këmbimin e pronës komunale me prone private, që bëhet fjalë për zone kadastrale ne Ratkoc. Qëllimi i këmbimit te pronës komunale me prone private është hapja e rrugës e cila faktikisht ne terrene është me shume se 30 vite e asfaltuar ne atë zonë, që bëhet fjale per zonën kadastrale ne Ratkoc 02440-0 që është pronë shtetërore e Kosovës KK.Rahovec, ku kësaj prone i merret sipërfaqja prej 4,86 m2 që ndahet prej pjesës se përgjithshme dhe i jepet ne bashkposedim Binak Arif Hoti dhe Ali Januz Hoti nga fshati Ratkoc. Ndërsa ngastra sipas certifikatës 1713/5 e cila është ne bash posedim te pronarëve te lartpërmendur i merret me sipërfaqe e përgjithshme prej 5,9m2. Qëllimi i këtij këmbimi është që kur është hapur kjo rrugë dhe është asfaltuar ju është marr pronarëve privat. Kjo sipërfaqe e përgjithshme ne total prej 5,9m2 asnjëherë nuk ju është kompensuar me pronë apo shpronësuar me mjete materiale, pasi pronaret e njëjtë në kufi me këtë parcelë e kanë ne shfrytëzim faktikisht e jo juridikisht dhe kanë te ndërtuar një objekt dykatëshe dhe jetojnë ne atë objekt për me shume se 30 vite. Kështu që kemi kërkuar prej juve që të na jepni pëlqim që te këmbejmë për këtë pronë për interes te përgjithshëm që e kemi shpallur edhe ne Mars te vitit te kaluar. Ftojë kuvendaret që pas shqyrtimit te aprovojnë vendimin për këmbimin e pronës komunale me pronë private.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor, gjithsesi ne e kemi trajtuar edhe ne Komitetin për Politikë dhe Financa dhe i kemi rekomandua kuvendit për me tutje.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtorë, kolegë kuvendarë, media dhe gjithë ju të pranishëm. Edhe në seancën e kaluar kam votuar kundër vendimeve ose propozim vendimeve për këmbim të pronës. Kështu që jemi për më pak se 5 muaj para zgjedhjeve dhe nuk kemi të drejtë me marr këso vendime. Kështu që kryesues merret përgjegjësia kolektive këtu por edhe individuale, kështu që ju them

sinqerisht se edhe nëse merrni vendim po ju garantoj se nuk do të certifikohet pasi që nuk kemi të drejtë që 6 muaj para zgjedhjeve me marr këso vendime.

Kryesuesi – Edhe në mbledhjen e kaluar e kemi diskutuar edhe e kemi sqaruar që presidenca i shpall datën e zgjedhjeve dhe deri sa nuk kemi datë të caktuar për shpalljen e zgjedhjeve ne i kryejmë obligimet e tona dhe kemi Ministrinë e Pushtetit Lokal e cila i konfirmon vendimet tona, pasi ne kemi marr katër vendime në mbledhjen e kaluar dhe i kemi konfirmimet e ligjshmërisë nga MAPL-ja.

Isak Hoti – Përshëndetje për ju kryesues, nënkryetar, drejtorë, delegatë të kuvendit dhe gjithë ju te pranishëm. Pra, ligji e specifikon qartë, që deri në momentin kur presidenca i shpall zgjedhjet me ligjin e fundit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale edhe në momentin kur presidenca i shpall zgjedhjet, e që realisht nuk ka qenë e specifikuar në ligjin e vjetër.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Hoti, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar e qesim në votim pikën e tretë të rendit të ditës. Konstatoj se me një votë kundër nga z. Fehmi Hoxha, aprovohet pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim me pak se një vite të pronës së paluajtshme të Komunës.

Mirsad Shala – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtor të drejtorive, anëtarë të kuvendit dhe gjithë ju te pranishëm. Siç jeni në dijeni në muajt e kaluar, ky kuvend ka marr vendim që rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim për me pak se një vite të pronës së paluajtshme të komunës që të del në debat publik. Kjo rregullore ka ardh si detyrim për të gjitha komunat në bazë të nenit 6, paragrafi 1, pika 1.3 e ligjit Nr. 06 L092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës si dhe neni 7 të rregullore 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës i cili ligj dhe rregullore obligon komunat që ta kenë një rregullore për dhënien në shfrytëzim për me pak se një vite të pronës së paluajtshme të komunës. Kolegji i zyrtarëve ligjor në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ka marr iniciativë për hartimin e kësaj rregullore e cila do të jetë unike në të gjitha komunat duke marr parasysh specifikat e komunave. Në si sektor ligjor në bashkëpunim me drejtor të drejtorive e kemi hartua këtë rregullore si dhe kjo rregullore ka qenë në debat publik në platformën për konsultime publike në kuadër të qeverisë së Republikës së Kosovës dhe gjithashtu kemi mbajtur edhe një konsultim publik në platformën online me të interesuarit dhe kanë ardh disa propozime. Propozimi që ka ardh është të hapësirat publike nëni 5 dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për me pak se një vit, hapësirat publike që janë parqet, bulevardet, sheshet dhe drejtorja e shërbimeve publike ka kërkuar që të futen edhe parkingjet për dhënien në shfrytëzim deri në 1 vite. Andaj pas konsultimit nga ana e juaj, pres nga ju kuvendare të nderuar që ta miratoni këtë rregullore shumë të rëndësishme për komunën tone.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Shala për prezantimin tuaj, të nderuar kolegë kuvendarë mendoj që të gjitha procedurat ligjore i ka kaluar dhe po ashtu ka qenë edhe në diskutim publik kjo rregullore edhe gjithashtu edhe në Komitetin për Politike dhe Financa e kemi trajtuar dhe i kemi rekomanduar kuvendit. Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar sa i përket kësaj pike, e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i plotësim ndryshimit të vendimit 01 Nr.180/21, i datës 29.03.2021 të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.

Mirsad Shala – Kuvendi i Komunës së Rahovecit me 29.03.2021 ka marr vendim për miratimin e planit lokal për menaxhimin e mbeturinave të ngurta. Mirëpo pas dërgimit të këtij vendimi në MAPL e cila e ka cedue tek ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe infrastrukturës, e njëjta na ka rekomandua që këtij vendimi të i shtohet në hyrje në hyrje në bazën ligjore në bazën ligjore pjesën hyrëse nëni 10.15 dhe nëni 40 i ligjit për mbeturina. Gjithashtu terminologjia e këtij vendimi është ndryshuar pasi që nuk mund të

quhet ne bazë te ligjit mbeturinat e ngurta por duhet te jetë vendim për miratimin e planit lokal për menaxhimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore. Vendimi si tërësi do te jetë i njëjtë përpos bazës ligjore te cilët janë shtuar këto nenet e ligjit për mbeturina.

Rasim Fazliu – Unë desha të ndërlihem me këto çka i tha përfaqësuesi Mirsadi dhe është mirë me u përgatit dokumentet dhe vendimet mirë pasi e kemi edhe zyrën ligjore këtu pasi si shpesh po kthehen vendimet e miratuara nga ne. Kështu që, pasi kemi gjithë infrastrukturën, pra zyrën ligjore dhe të gjitha kushtet, atëherë kur përgatiten pikat e rendit të ditës apo kur merren vendimet e caktuara do të ishte mirë të bëhen ashtu siç duhet edhe mos me ju dhanë hapësirë MAPL-së që me na u kthye vendimet pasi vërtetë nuk është edhe ne rregull kjo. Kështu që propozoj që herëve tjera me qenë më të vëmendshme edhe mos me ardh deri te përsëritja e vendimeve pasi që nuk ne rregull kjo.

Kryesuesi – Faleminderit z. Fazliu për kontributin tuaj, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim pikën e peste te rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë ne pikën e gjashtë te rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i plotësim ndryshimit te vendimit 01 Nr.181/21,i datës 29.03.2021 të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave te vëllimshme.

Kryesuesi – Të nderuar kolegë kuvendarë, ashtu siç ju informova edhe me herët se pika 5 dhe 6 janë të njëjta, kështu që e qesim ne votim edhe pikën e gjashtë të rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë ne pikën e shtatë te rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Plotësim ndryshimit të rregullores për vendosjen e objekteve te përkohshme në territorin e Komunës se Rahovecit 01 Nr.2558 të datës 27.06.2014.

Mirsad Shala – Të nderuar kuvendarë, siç e keni edhe ju ne formë fizike pasi që ky është një propozim që ka ardh për plotësim ndryshim te rregullores për vendosjen e objekteve te përkohshme ne territorin e komunës se Rahovecit 01 Nr.2558 te datës 27.06.2014. Në këtë propozim nenet 10,11,12,13 duhet që te shfuqizohen për shkak se këto nene ne këtë rregullore flasin për dhënien ne shfrytëzim te tokës komunale, gjë që ne e kemi tek dhënia në shfrytëzim te rregullorja për dhënien në shfrytëzim deri ne një vite. Kështu që këto nene bien ndeshë me rregulloren për dhënin në shfrytëzim me pak se një vite dhe duhet te shfuqizohen këto nene dhe nenet tjera do te mbesin ne fuqi.

Fehmi Hoxha – I nderuar, neni 10,12,13 po shfuqizohen, atëherë a mundesh me na lexua nenin 15 këtu edhe njëherë që bazohet ne nenin 10, pasi unë mendoj se është gabim dhe duhet të rregullohet. Pasi këtu përmendët neni 10 tek neni 15 dhe nëse e largojmë nenin 10 atëherë neni 15 faktikisht s'ka bazë dhe kjo është arsyeja se ju thash që ta lexoni nenin 15, pasi lidhet direkt me nenin 10-të.

Mirsad Shala – Faleminderit kryesues, atëherë neni 15 ka të bëjë me të drejtën e ankesës, që precizon kundër çdo aktvendimi apo akti tjetër të nxjerrë nga organi përgjegjës kompetent nga neni 10, në bazë të rregullativës, pala e pakënaqur ka te drejtë ankese në afat prej 30 dite. Kështu që kërkoj falje për gabimin teknik se është edhe ky nen te shfuqizohet pasi ka te bëjë me nenin 10.

Kryesuesi – Faleminderit z. Shala për kontributin, e qesim ne votim pikën e shtatë te rendit të ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë ne pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues te ofertave për dhënien ne shfrytëzim afatshkurtër te pronës ë paluajtshme te komunës 01 Nr.189/21,të datës 29.04.2021.

Të nderuar kolegë kuvendarë, pika e 8,9,10 dhe 11 të cilët i kemi pasur ne mbledhjen e kaluar për dhënien në shfrytëzim të pronave, na është kërkuar nga MAPL-ja dhe janë të konfirmuara ligjërisht por duhet që për secilën pronë që jepet në shfrytëzim të mos jetë i njëjti kryesues i komisionit dhe jo për te gjitha vendimet të jetë i njëjti komision i përfshirë, pra të bëhet ndryshimi brenda grupit apo komisionit dhe për secilin vendim që jepet ne shfrytëzim te jetë kryesues i komisionit te mos jetë i njëjti person. Kështu që ne ju kemi përgjigjur pozitivisht dhe jemi zotuar që për mbledhjen e ardhshme sigurisht se do ta bëjmë këtë. Pra për

pikën e tetë të rendit të ditës e keni edhe listën ku për secilën edhe ndoshta po mundeni me vërejt në mbledhjen e KPPF-së kemi pasur një pjesë të mbledhjeve ku emrat ishin të njëjtë kurse mbledhjet ishin të ndryshëm.

Fehmi Hoxha – E para e shoh Artan Asllani aty, unë mendoj që drejtori i drejtorisë nuk ka të drejtë të jetë kryesues por duhet të jetë shërbyes civil, pastaj Refki Kryeziu që është anëtarë i kuvendit dhe nuk ka të drejtë të jetë kryesues, kështu që përsëri duhet dikush prej ekzekutivit me qenë kryesues e jo i kuvendit, pra këto ishin vërejtjet e mia.

Isak Hoti – Atëherë neni 17 i ligjit të dhënies për shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale e specifikon qartë formimin e komisionit për vlerësimin e ofertave, ku kryetari i komunës i propozon dy anëtarë nga ekzekutivi i komunës dhe jo nga shërbyes civil, pastaj dy anëtarë prej kuvendit të komunës dhe një nga shoqëria civile. Pra, janë dy nga ekzekutivi që fakt janë drejtorë, dy janë nga legjislativa pra nga kuvendi i komunës dhe një nga shoqëria civile që është anëtar i një OJQ-je. Për sqarim të kjo çështje jo veç të ne por ka ndodhur ne të gjitha komunat pasi vërtet ishte absurde sepse kisha një takim me sekretarin e përgjithshëm dhe jemi ardhur në konkludim se kjo çështje e komisionit pasi në të kaluarën kemi pasur një vendim të përhershëm për vlerësim të ofertave. Kështu që nuk është në interesin e tyre që me na tregua neve se a i bëjmë të njëjtin komision apo i ndërrojmë njerëzit sepse është shumë problem pasi një delegat nuk ka të drejtë të jetë edhe në një komision tjetër. Kështu që për shkak të numrit jemi detyruar me bo rotacion të njerëzve të njëjtit vendim, kështu që edhe ata ishin të pajtimit se kjo është përgjegjësi e juaja dhe jo e jona. Pra, megjithatë u siguroam që mos me na u kthye ata katër vendime edhe ne i bëjmë këto vendime që absolutisht për mua janë në rregull dhe brenda ligjit.

Kryesuesi – Faleminderit z. Hoti për sqarimin, të nderuar kolegë e qesim në votim pikën e tetë të rendit të ditës. Konstatoj se me një votë kundër nga z. Fehmi Hoxha aprovohet pika e tetë e rendit të ditës. Kalojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr.190/21, të datës 29.04.2021.

Kryesuesi – E qesim në votim pikën e nëntë të rendit të ditës. Konstatoj se me një votë kundër, aprovohet pika e nëntë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr.191/21, të datës 29.04.2021.

Kryesuesi – E qesim në votim pikën e dhjetë të rendit të ditës. Konstatoj se me një votë kundër, aprovohet pika e dhjetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës 01 Nr.192/21, të datës 29.04.2021.

Kryesuesi - E qesim në votim pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës. Konstatoj se me një votë kundër, aprovohet pika e dhjetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Informatë nga DSHPS-ja rreth pandemisë Covid-19.

Samir Mustafa – Përshëndetje për të gjithë. Po ju paraqes informatën rreth situatës pandemike Covid-19 në komunën e Rahovecit. Aktualisht janë 1179 raste të paraqitura nga fillimi i pandemisë, ku rastet e shëruara janë 1092 raste, aktive janë 16 raste, ndërsa me fatalitet janë 71 raste të paraqitura. Rasti parë është paraqitur me 24.04.2020 ndërsa rasti parë me fatalitet është paraqitur me 8.05.2020. Vazhdon rregullisht dezinfektimi i institucioneve shëndetësore, po ashtu vazhdon testimi i të dyshuarve kundër Covid-19 me teste antigjene rapide të shpejta në QKMF, po ashtu vazhdon vaksinimi kundër Covid-19, që nga fillimi i vaksinimit deri me tani janë vaksinuar 1704 qytetarë, ku prej tyre 1404 janë vaksinuar me vaksinën Astra Zeneca ndërsa 300 me Pfizer. Aktualisht kemi në dispozicion 400 doza të vaksinave Astra Zeneca që ruhen

sipas rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë për vaksinimin e dytë. Kjo është një informatë e shkurtë sa i përket rreth pandemisë.

Fahrie Lushi – Faleminderit kryesues, të nderuar këshilltar dhe gjithë të pranishëm. Edhe në KPF e kemi diskutuar mjaft gjërë këtë informatë, ndërsa sot është në rregull drejtshkrimi rreth kësaj informate mirëpo drejtori sot edhe me ato që i ka përmend edhe nga kjo informatë që janë duket se janë pak me ndryshime në shifra. Tash brenda një jave sa ka qenë mbledhja e KPF-së dhe mbledhja e rregullt i kemi, pasi nga KPF-ja deri në këto momente i kemi gjithsej 1167 raste ndërsa sot i kemi 1173 raste me Covid, që d.m.th. janë aktiv, pastaj raste aktive 26 ndërsa të KPF-ja raste aktive 270. Pra, do të ishte mirë që kaq shpejt ka mbërri shifra e të shëruarve, pastaj të shëruar janë 827 kurse sot i kemi 1076 të shëruar, pra, nga data 20.05.2021 e deri më sot që 28.05.2021, të shëruar me datë 20 i kemi pasur 827 raste kurse sot i kemi 1076 raste të shëruar dhe pastaj me fatalitet është 71 që i bien një më tepër se nga java e kaluar. Dhe, ajo që më tepër na ka shqetësuar apo që ka qenë në qendër të vëmendjes është shifra të cilën e kemi ndaje në kuvend dhe jo vetëm vendimi i kryetarit pasi që ka qenë propozim vendim që janë ndaje 10,000 euro mjete ku thuhet nga informata e kaluar e KPF-së të cilat më tepër kanë qenë të dedikuara shtabit emergjent për të ndihmuar Covid-19 d.m.th. për t'i shërbyer specifikisht për Covid-19. Ndërsa sqarimet që i ka dhënë drejtori i Financave, kanë qenë se 1/3 kanë qenë për drejtorinë e shëndetësisë pastaj pjesa tjetër ka qenë në ato që edhe sot do të na jepni sqarim pasi ju e dini më saktësisht por është shqetësuese sepse janë ndaje 10,000 euro dhe ne vet informatën tuaj thuhet se si drejtori vazhdimisht kemi qenë të ballafaquar me mungesë të materialit mbrojtës, për personelin mjekësor, ku janë ato pajisjet elementare që ju kanë munguar stafit shëndetësorë, duke filluar nga maskat, dorëzat, dezinfektues dhe po ashtu edhe rroba për personel që gjatë asaj kohe sa ka qenë pandemia në kulm pothuajse dhe stafi shëndetësor të përballet me këto mungesa ndërsa ne si kuvend kemi ndarë 10,000 për mjete atëherë kjo nuk është diçka në rregull dhe është në kundërshtim me atë që e kemi përmend që 10,000 euro i kemi ndarë specifikisht për shtabin emergjent Covid-19. Pra, kërkoj sqarim edhe njëherë lidhur me këto mjete se ku janë shpenzuar apo nuk janë shpenzuar e gjitha për stafin shëndetësor apo Covid-19.

Sali Sallteku – Faleminderit kryesues, siç e tha edhe zonja Lushi se vërtet ka ndryshime në numër pak mirëpo pak rëndësi, por unë desha me ja bo një pyetje drejtorit se këto dy vaksina siç e potencuat që kishit rreth 400 rezerva mirëpo kjo tjetra vaksinë amerikane Pfizer a pritet me ardh me shpejt edhe a do t'i vaksinoni edhe punëtorët e arsimit se shpejti, bile ata që janë mbi moshën 60 vjeçare.

Masar Popaj – Te lista e objekteve të dezinfektuara në komunën e Rahovecit, ku shihet që ka edhe në sektorin privat që janë 3 kompani private që kanë një numër të konsiderueshëm në komunën e Rahovecit, cilat janë ato kompani që kanë një numër të madh të punëtorëve që janë të dezinfektuara dhe si informatë është shumë e thatë pasi nuk ka më shumë se 1 vjet dhe nuk ka të dhëna ashtu siç duhet.

Samir Mustafa – Shifrat që i përmenda janë të datës 27.05.2021 dhe në çdo ditë pas orës 15:00 i marrim informatat nga Instituti kombëtar i shëndetit publik, kështu që ka pasur ndryshim pozitiv. Kurse sa i përket shpenzimit të ndarë nga kuvendi i komunës në shumen prej 10,000 euro keni marr përgjigje në KPF, pastaj pyetja e parashtruar nga Sali Sallteku rreth furnizimit, siç e dini furnizimin e bën ministria e shëndetësisë dhe po ashtu për vaksinimin e stafit të arsimit sigurisht se prapë vendos ministria e shëndetësisë. Kështu që aktualisht vaksinohen vetëm qytetaret moshës mbi 65 vjeç, pra as të sëmurët me sëmundje kronike nuk kanë të drejtë me u vaksinua me këtë sistem që e ka ministria e shëndetësisë. Pastaj pyetja e parashtruar nga Masar Popaj rreth dezinfektimit të objekteve, në fillimin e pandemisë kemi pasur kërkesë nga kompanitë të ndryshme dhe janë dezinfektuar mirëpo me qetësimin e situatës kompanitë janë rikuperuar dhe vet i kanë bërë dezinfektimin e kompanive.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimet, të nderuar kolegë kuvendarë kalojmë në pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës:


13. Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën Janar – Prill. Fatmir Iska – Ne mungesë të drejtorit të bujqësisë që është në një takim në Ministrinë e Bujqësisë së bashku me Kryetarin, ku do të diskutohet rreth pagesës së subvencioneve dhe shpresojmë që të na vinë me informata sa më të mira por sigurisht do të diskutohet edhe për tema tjera dhe krejt kjo në interes të bujqve dhe fermerëve të komunës tonë. E kemi një informatë ku është e shënuar për periudhën Janar – Maj mirëpo në material është e trajtuar për periudhën Janar – Prill 2021, meqenëse muaji Maj ende nuk ka përfunduar. Sigurisht se kjo informatë është përgatitur në bazë të planit të punës që e ka hartuar drejtoria për Bujqësi, pastaj kemi dëmet e shkaktuara që janë paraqitur në fillim të vitit kryesisht në Janar dhe janë formuar komisionet në bazë të vendimit të kryetarit të komunës dhe gjithashtu komisionet kanë dalë në terrene dhe kanë bërë evidentimin dhe gjithashtu kanë bërë procesverbalet për secilin fermerë dhe me pastaj janë dërguar në Ministrinë e Bujqësisë që realisht deri më tani nuk kemi ndonjë përgjigje nga ana e tyre, ku janë të cekur kulturat që janë dëmtuar pastaj vreshtat, perimet, dëmtimi i serrave që kanë ndodhur kryesisht në konstruksion dhe pjesën e najlonit dhe gjithashtu janë të cekura edhe me sipërfaqe që janë të ilustruara disa nga fotografitë këtu. Po ashtu janë të cekura edhe për aplikimin për 1 litër qumësht që është aplikuar për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2020, pra 15 Janar – 15 shkurt ka qenë afati i aplikimit, që gjithsej kanë qenë 89 fermerë dhe mbi 2 milion litra qumësht që janë regjistruar, shpërndarjen e mekanizmave bujqësor kryesisht që janë bërë gjatë këtij vitit ku ceken aty 68 multikultivator, 20 llaktofriza, 8 komora ftohse që janë shpërndarë për fermerë, dhënia e pronave të paluajtshme gjithsej 6, ku prej tyre 3 kanë kaluar procesin dhe pastaj janë rishpallë ankandin dhe të gjitha këto shkojnë në bazë të kërkesave që i kanë fermerët, aplikimin për pagesat direkte që ceket edhe në faqen e fundit si sfida e drejtorisë për vitin 2021 pasi ende nuk ka filluar dhe ne jemi të gatshëm pasi edhe i kemi këshilltarë që brenda u bë mjaft e madhe, tash se fundi në Prizren u shpall një konkurs njëjtë për 47 këshilltarë. Pra kemi një ekip me njerëz të kontraktuar nga komuna që kanë me asistuar dhe prej tyre 7 janë vetëm në drejtorinë e bujqësisë, e po ashtu siç ka funksionuar edhe vitin e kaluar në Ratkoc dhe në Krushë të Madhe kanë me qenë zyrtar kontaktues, në mënyrë që me ju krijua me lehtë fermerëve tanë. Pastaj skemën e granteve në bazë të kompanisë projektuese, kanë aplikuar 48 fermerë, ku prej tyre 35 janë për ndërtim të stallave, 5 në sektorin e qumështit, 2 për vezë, 3 për depo për ruajtjen e prodhimeve bujqësore dhe gjithsej vlera e këtyre projekteve është afërsisht 2 milion. Po ashtu kemi vaksinimin e bagëtive dhe qeneve shtëpiak gjithashtu në këtë informatë shihet edhe vaksinimi apo trajtimi i qeneve endacak në sasi siç ka qenë e përcaktuar me kontratë. Pra e kemi të paraqitura të gjitha në formë tabelare, pastaj ndërtimi i serave me participim 80% me 20% dhe deri me tash janë ndërtuar 105 sera prej gjithsej 243 aplikime apo përfitues sa janë dhe kjo sigurisht që shkon gradualisht në baze të participimit të qytetarëve dhe këto janë të ndara në dy lote me 3 dhe 10 ari në njërin lotë dhe 5 dhe 7 në lotin tjetër. Pastaj kemi edhe ndërtimin e stallave, gjithsej janë ndërtuar 11 stalla për lope qumështore dhe 3 për sektorin e bujqësisë. Gjithashtu do të bëhet edhe një projekt tjetër për këtë punë, do të bëhet edhe një kontratë e re rreth sfidave të DBPZHR-së që janë afërsisht 600 bujq që ende nuk janë paguar prej pagesës së dyfishtë së subvencionimit, kështu që presim sot lajme të mira të kryetarit të komunës me drejtorinë e bujqësisë që do ta kenë takimin me ministrinë e bujqësisë dhe gjithashtu sfida janë edhe kontratat për rregullimin e rrugëve fushore, kanaleve të kullimit e plot punë të tjera, pasi vitin e kaluar janë trajtuar gjithsej vetëm me buxhetin e komunës afërsisht 84 km rrugë dhe unë besoj që ka edhe me shumë nevojë për trajtimin dhe rregullimin e rrugëve fushore, kështu që ne jemi në këtë proces dhe presim javën tjetër nëse nuk do të këtë ankesa të lidhet kontrata e re dhe të fillojë me trajtimin e rrugëve fushore. Pra nuk dua të zgjatem me tepër meqenëse edhe drejtori i bujqësisë nuk është i pranishëm, nëse ka ndonjë

pyetje do te jemi te gatshëm me ju përgjigj ndërsa për ato që nuk kemi mundësi tani do te përgjigjemi ne seancën e ardhshme.

Ali Zhuniqi – Në këtë pikë te rendit të ditës me ngritë çështjen që ka të bëjë me rregullimin e rrugëve fushore, pasi është kërkesë e bujqve e konkretisht te rruga Asllani apo rruga për Kalldërm e cila ka vështirësi mjaft të mëdha me prishjen e asaj rruge dhe meqenëse ju e përmendet se është sfidë dhe do të merren masa rreth këtyre rrugëve atëherë ne presim që ky problem të rregullohet. Pastaj te fermerët që kanë hasur ne vështirësi në plasimin e produkteve bujqësore për shkak të vështirësive dhe rrethanave te pandemisë. Kështu që nëse kthehemi ne periudha paraprake është bërë një lloj drame nga njësia speciale rreth plasimit të produkteve bujqësore dhe njerëzit që merren me serra dhe me krahësua me periudha atëherë shohim që në këtë periudhë në plasimin e produkteve të tyre nuk është që ka pasur lehtësim të masave për sa i përket plasimit dhe në ndërkohë në pjesën ku pikërisht janë shitur ato produkte shohim që nuk ka aktivitet aty. Dhe kjo nënkupton se keni bërë një lloj drame në atë kohë dhe nuk është kon mirë dhe në të njëjtën kohë e shohim vazhdimisht pasi e frekuentoj çdo herë atë rrugë ku është bërë problematik dhe tash nuk është zhvilluar ndonjë aktivitet. Kështu që duhet me pas kujdes pasi këto gjëra politike ndoshta i kontribuon një momenti të caktuar por nuk i kontribuon qytetareve.

Fatmir Iska – Edhe me përpara rrugën fushore e përmenda dhe shpresojmë që të lidhet kontrata dhe do të vazhdon pasi ajo rrugë është veç ne projekt pasi ndoshta me herët nuk e përmenda që për shkak të reshjeve ne fillim te vitit që kanë ndodhur atëherë janë dëmtuar shume rruge fushore dhe kryesisht janë dëmtuar rrugët që janë ndërtuar një javë para reshjeve te shiut. Pra ne kalojmë ne ato rrugë dhe i shohim çdo ditë kështu që shpresojmë që te lidhet kontrata sa me shpejt dhe kjo rruge te përfundoj. Sa i takon plasimit te produkteve bujqësore dhe ajo që ka qenë dhe ne kemi informatë për vitin 2021 për muajt janar shkurt mars dhe prill dhe ajo ka ndodhur vitin e kaluar edhe sigurisht se fermerët kanë qenë shume te shqetësuar për arsye se nuk kanë pasur se ku me i plasue produktet si shitja e fidanëve pasi edhe ju Ali Zhuniqi bashke me mue jemi fermerë edhe shitjen e fidanëve nuk kemi pasur mundësi se ku me i shitë dhe ka pasur mjaft vështirësi pasi kanë te ndaluara tregjet dhe ne jemi munduar që të bëjmë zgjidhje dhe ju e dini shume mirë se nuk është politizue ajo pasi nuk është e drejtë me politizue me fermerët. Kështu që jemi munduar me ju dal ne ndihmë fermerëve në mënyrë që ti shesin ato fidanë, pasi me kujtohet shume mirë pasi kam qenë ne oborr te komunës dhe ka qenë ditë e shtune edhe kanë kërkuar me ju bo zgjidhje që me pas mundësi me shit produktet bujqësore te tyre pasi edhe unë rrushin që e prodhoj dikun duhet me shitë apo me plasue dikun. Pra me mbylljen e gastronomisë dhe të masave tjera kjo direkt ka shkakuar telashe te fermeri apo bujku, e kryesisht ne perimtar, pasi që p.sh. nëse nuk funksionon një sallë e dasmave që konsumon te gjitha këto produkte atëherë sigurisht se për fermerin ka telashe. Kështu që tregjet ndoshta janë te hapura tash edhe me vendim te ri pastaj a janë njerëzit te interesuar me shkue me ble aty atëherë është krejt diçka tjetër, por ne jemi te obliguar me ju ofrua mundësi dhe kushte me ju krijua që ata mos me pas problem sa i përket plasimit të produkteve të tyre në tregje.

Kryesuesi – Faleminderit shumë nënkryetar për të gjitha sqarimet, të nderuar kolege kuvendarë duke ju falënderuar te gjithëve për kontributin tuaj ne këtë seancë dhe shihemi ne mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

